



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



FONDI I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR
Njësia e prokurimit

Nr. _____ Prot.,

Tiranë 30/05/2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - sherbim

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Mirëmbajtje riparim dhe vendosjen e pjesëve të këmbimit për automjetet e Fondit për vitin 2024”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Sherbime, Kodet CVP: vendosje pjeseve te kembimit dhe mirembajtje per automjete

VLERA E FONDIT LIMIT: 1,869,600 (Një milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind) lekë pa tvsh Fonde të tjera;

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3, ne masen 2% te e vlerës së përlogaritur të kontratës ne nje nga format e parashikuara ne ligjin nr.162/2020 date 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” konform nenit 83, perkatesisht ne vleren prej 37,392(tridhjet e shtate mije e treqind e nenetedhjet e dy)Leke.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Për të provuar përmbushjen e kapaciteteve të mëposhtme, Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Për kapacitetin ligjor/profesional:

Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me Liçencën e kategorisë VII.3.B.1, ”Riparimi dhe mirëmbajtja e pjesëve mekanike dhe të motorrit, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, për pikat a, c, ç, në përputhje me legjislacionin, për lejet dhe liçencat, si dhe Udhëzimin e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, me Nr.1546, datë 29.03.2016, ”Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, për ambientin ku ushtron këtë aktivitet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 41, pika 4 , gërma a) e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”; si dhe në zbatim të **Udhëzimit të Ministrit të i Transportit dhe Infrastrukturës Nr.1546, datë 29.03.2016**, “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

Operatori ekonomik duhet të jetë i standartizuar sipas standartit me Çertifikatat ISO të njohura dhe akredituara nga institucionet përkatëse shtetërore shqiptare.

-Operatori ekonomik duhet të paraqes Çertifikatë të cilësisë ISO 9001 – 2015(e vlefshme). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO.

-Operatori ekonomik duhet të paraqes Çertifikatë të cilësisë ISO 14001 – 2015(e vlefshme). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO.

Argumentimi: Çertifikatat e kërkuara duhet të jenë të vlefshme ne kohen e zhvillimit te procedures së prokurimit. Çertifikata e mësipërme duhet të jenë në gjuhën shqip ose të jenë të përkthyer në shqip, si dhe origjinale ose të njehsuara me origjinalin (kopje të noterizuar). Çertifikatat duhet të jenë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



të njohur nga Republika e Shqipërisë. Ne rastet kur oferta dorezohet nga nje BO, operatorët duhet te disponojne certifikatat e kerkuara në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

3.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- a) Deklaratë për xhiron mesatare vjetore të 3 (tri) viteve të fundit financiare (2021, 2022, 2023) ku vlera e saj të jetë jo më e vogël se **30%** e fondit limit.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, tëVKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e xhiros se percaktuar dhe te kerkuar nga autoriteti kontraktor kerkohet për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike te operatorit ekonomik si dhe per të vendosur kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ne legjislacioni tatimor ku xhiroja dhe bilancet kane si afat perfundimtar per tu mbyllur dhe dorezuar prane organeve tatimore maksimumi deri ne fund te muajit Prill te vitit qe vjen.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar sipas ligjit nr.8438 date 28.12.1998 i ndryshuar. (Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

3.2 Kapaciteti teknik:

- a) Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të ketë furnizime të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se **20%** e vlerës së fondit limit, të realizuara gjatë tri
-



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



viteve të fundit (2021, 2022, 2023) nga data e hapjes së ofertave të kësaj procedure prokurimi.

Për të vërtetuar këtë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve per proceduren e hapur te thjeshtuar eshte percaktuar se vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

4 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë personelin teknik të nevojshëm për realizimin e kontratës, në përbërje të të cilit të ketë minimalisht punonjës sipas profileve të më poshtë:

- 1-Motorrist
- 2-Pompist
- 3-Mekanik/Xhenerikë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



4-Elektroaut

Për të vertetuar se operatori ekonomik ka të punësuar në stafin e tij teknik personelin teknik me profilet e punës të cituara më sipër, për secilin prej tyre duhet të paraqesë :

Kontratat individuale të punës si dhe ti ketë të deklaruar këta punonjës në profilet e kërkuara si më sipër në Listëpagesat e punonjësve (E-Sig 025) të deklaruar në organet tatimore, për periudhën Prill 2024 – Qershor 2024 sipas kodeve të punësimit të profesioneve të përcaktuara në **Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 514, datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP), të rishikuar”**.

Shënim: Kriteri konsiderohet i permbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DST ku te **specifikohen pikat e mësipërme.**, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij. Ky numer minimal është kërkuar duke u bazuar në numrin e automjeteve që kanë nevojë për kryerjen e shërbimeve, si dhe natyrën dhe numrin e shërbimeve që kërkohen. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjës të aftë profesionalisht për realizimin e objektit të prokurimit. Staf i kualifikuar është kërkuar në raport me shërbimet që kërkohen të realizohen

4.1 Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij :

-1(një) drejtues teknik

Për punonjësin, me profesion si më sipër, duhet të paraqesë:

-Diplomë

-Kontratë pune

-Librezë pune

Shënim: Kriteri konsiderohet i permbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DST ku te **specifikohen pikat e mësipërme.**, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga Operatori



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij. Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që kontraktuesi duhet të përcaktojë një person përgjegjës (drejtues teknik) për kryerjen e shërbimeve i cili kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij. Dokumentacioni plotësues i kërkuar në kriteret e veçanta për kualifikim pjesë përbërëse e dokumentave të tenderit, sikundër janë, kontratë pune e vlefshme, diploma etj janë vendosur për arsye se me paraqitjen e këtij dokumentacioni vërtetohet se ky person përgjegjës është operativ pranë Ofertuesve të mundshëm dhe në këtë mënyrë Autoriteti Kontraktor krijon bindjen se Operatorët ekonomikë pjesëmarrës zotërojnë personelin e nevojshëm për realizimin me sukses të objektit që prokurohet. Stafit teknik i kualifikuar është kërkuar ne raport me shërbimet që kërkohen te realizohen.

5.Operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion ambientin për ushtrimin e aktivitetit servis automjetesh,si vijon:

Vendndodhja e servisit duhet të jetë brenda Qytetit të Tiranës me një sipërfaqe jo më të vogël se 300 (treqindë m2) e cila duhet të vërtetohet me paraqitjen e Çertifikatës së Pronësisë, ose me Kontratën e Qiramarrjes te noterizuar shoqëruar me Certifikatën e Pronësisë, të cilat duhet të jenë origjinale ose të noterizuara.

Shënim: *Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 9 të DST ku te specifikohen pikat e mësipërme., ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohët vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” AK kërkon që OE duhet të disponojë servis për riparimin e automjeteve, kërkesë e cila është e domosdoshme vendi dhe adresa ku automjetet e AK do të paraqiten sipas planifikimit për të realizuar shërbimet që parashikohen dhe riparimet e difekteve të rastit për çdo rast të nevojshëm por më e rëndësishme eshte per te krijuar e besueshmerine ne realizimin me sukses te kontrates Sa i perket siperfaqes prej 300 m2 ky kriter eshte vendosur per te krijuar sigurine qe operatori ekonomik ka mundesine per te parkuar automjetet pasi riparimi mund te kerkoje dhe nje afat mbi 24 ore per riparimin.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



Bazuar ne ligjin nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, të ndryshuar. Ambientet e ushtrimit te aktivitetit në pronesi ose me qera të jene të pasqyruara në Ekstraktin e QKB-së.

5.1 Servisi duhet të jetë i pajisur minimalisht me repartet dhe pajisjet teknike të nevojshme bashkohore për realizimin e kontratës si më poshtë:

Pajisje (kompiuterike) për kontrollin dhe testimin (diagnostikimin) e sistemit elektrik dhe difekteve në motorr të automjetit.

a) Repart xhenerik me jo më pak se 3 (tre) linja kontrolli teknik të pajisur përkatësisht secila me:

- Urë për ngritje dhe kontroll të mjetit me rrota të mbështetura dhe të varura, me kapacitet jo me pak se 2.5 ton e përshtatshme edhe për fuoristrada;
- Pajisje (kompjuter) për kontrollin dhe testimin e sistemit frenimit të automjetit.
- Pajisje (kompjuter) për kontrollin dhe testimin e sistemit amortizimit të automjetit.
- Pajisje për kontrollin fizik në sistemin e drejtimit dhe amortizimit për autovetura, fuoristrada dhe furgona.
- Pajisje për ndërrimin e fluidit (alkoolit) për komplet sistemin e frenimit.

b). Repart motorist me pajisjet e kontrollit si më poshtë:

- Paisje për vënien në faze të motorrit të mjetit.
- Pajisje për matjen e komprimimit në motorët diesel dhe me benzinë.
- Paisje për testimin e sistemit të ftohjes motorrit, kontroll radiatorit etj.
- Pajisje (kompjuter) për kontrollin e sistemit të ushqimit, injektoreve, sprucatoreve , pompë naftë, pomë benzine etj.
- Pajisje për kontrollin dhe mbushje me gaz të sistemit A/C.
- Pajisje të lëvizshme (portabile) për ndezje emergjente të mjetit 12v & 24v.

c) Repart elektroauto i pajisur me pajisjet si më poshtë:

- Pajisje (kompjuter) për regjistrimin e fenerëve.
- Pajisje matëse për impiantet elektrike
- Pajisje për diagnostikimin e të gjithë sistemit elektronik të automjetit.

Per pajisjet dhe instrumentat e mesiper operatorin ekonomik duhet te paraqese deklaraten qe i disponone keto pajisje



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



Argumentimi :Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicionmjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. specifikat e çdo pajisje janë të lidhur ngushtë me specifikat e përshkruara ne zërat e riparimit te kërkuara.

6.Operatori ekonomik duhet të provojë që pjesët e këmbimit, për të cilat do të kryhen shërbimet e kërkuara, janë të furnizuara nga prodhuesit ose nga distributorët e autorizuar nga prodhuesit. Në rast se do të paraqitet kjo e fundit, duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit. Dokumenti duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si : telefon, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor, në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: Në bazë nenit 41, pika 6 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se kane aftesite per te realizuar me sukses dhe sipas kriterëve riparimin e automjeteve.

6.1Operatori ekonomik duhet të deklaroje se ka në dispozicion, apo mund t’i vihet në dispozicion, minimalisht 1(një) karrotrec, për transportimin e automjeteve të difektuara, për të cilin duhet të paraqesë nje vetdeklarim.

Shënim: *Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 9 të DST ku te specifikohen pikat e mësipërme., ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohët vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicionmjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.AK kërkon që OE duhet të disponojë një automjet karrotrec, i cili do të jetë i nevojshën nëse ndonjë prej automjeteve të AK gjatë aktivitetit ditor pëson ndonjëdefekt të mundshmë dhe si pasojë lind nevoja per dergimin e mjetit të servisi i OE kontraktor.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



6.2 Deklaratë se pjesët e këmbimit që do të përdoren për riparimin e automjeteve, do të jenë të reja, dhe prodhim sipas standarteve të CE, për garancinë e pjesëve të këmbimit jo më pak se 1 vit, nga data e montimit.

Argumentimi: Në bazë nenit 41, pika 6 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se kanë aftësitë për të realizuar me sukses dhe sipas kriterëve riparimin e automjeteve.

NJESIA E PROKURIMIT

Arian Karroçi

Ergan Dollani

Fabiola Ribaj

